



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 169, datë 11.09.2019

PËR

SKUALIFIKIMIN DHE PËRJASHTIMIN E KANDIDATIT Z. {...} NGA PROCEDURA E EMËRIMIT NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e dates 11.09.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjëndjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë,

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës administrative.”**

2. Me Vendimin nr.109, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile”.**

3. Me Vendimin nr. 110, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës penale.”**

2. **Brenda afatit të përcaktuar dyjavor nga nga dita e publikimit të vendimit si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...} ka aplikuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurimit për pozicionet e lira të shpalluara përmes vendimeve të mësipërme, pa specifikuar pozicionin konkret për të cilin kishte aplikuar.**

3. Me Vendimin nr.142, datë 26.07.2019, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë” (pika 1).** Po me këtë vendim (pika 2, nëndarja 8), pas shortit të hedhur, për procedurën e verifikimit për kandidatin, z. {...}, është caktuar si relatore znj. Marçela Shehu.

4. **Më datë 26.07.2019**, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, **njoftoi kandidaten për: - fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit**, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin **për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit** ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit tre ditor, kandidati **depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik**, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, **kandidati nuk parashtroi asnjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

6. **Më datë 29.07.2019**, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, relatorja e çështjes, në rrugë elektronike, **njoftoi kandidatin për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit**, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.

7. **Po më datë 29.07.2019**, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, relatorja e çështjes, në rrugë elektronike, i dërgoi kandidatit **formularët dhe autorizimet përkatëse** (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesë ditor, **kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit**.

9. Me anë të komunikimit elektronik të datës **01.08.2019**, z. {...} i është kërkuar të plotësohet kërkesa për shprehje interesi duke **evidentuar një apo më tepër nga pozicionet** e lira të shpallura, ku kerkonte të konkuronte, në mënyrë që të mundësohej vijimi rregullisht i procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit dhe, me tej, te procedurës së perzgjedhjes së tij për t'u propozuar për emërimin në Gjykatën e Lartë. Theksojmë se edhe pas këtij komunikimi, z. {...} nuk ka përcaktuar në mënyrë eksplicite, kërkesën për shprehje interesi duke **evidentuar një apo më tepër nga pozicionet** e lira të shpallura.

10. Përmes njoftimit të datës **29.07.2019**, z. {...} është njoftuar për mangësitë në dokumentacionin e paraqitur dhe është ftuar të plotësojë dokumentacionin shoqëruar që vërtetonte përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, përfshirë edhe sa i përket kushtit **“të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”**. Theksohet se edhe pas këtij njoftimi z. {...} nuk ka paraqitur asnjë dokument që vërteton plotësimin e këtij kushti sipas Vendimit nr. 108; Vendimit nr. 109; Vendimit nr. 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

11. Pas të dhënave të grumbulluara në lidhje me mungesën e gradës shkencore të kandidatit, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet e nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi vlerësimin se në rastin konkret verifikohej një rrethanë që mund të çonte në përfundimin se kandidati nuk plotësonte një nga kushtet e emërimit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, relatorja e çështjes vuri në dijeni Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, i cili, mbështetur në shkronjën “a”, pika 12, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, me Vendimin e datës 28.08.2019, vendosi që: *“Kandidati z. {...} të ftohet për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij”*.

12. Mbi këtë bazë, **më datë 28.08.2019**, relatorja e çështjes, në rrugë elektronike, **njoftoi kandidatin për gjetjen e procedurës së verifikimit**, pra në lidhje me kushtin e kandidimit **“të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”**, duke e ftuar për të paraqitur shpjegime për gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe çdo dokumentacion mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij.

13. Me anë të komunikimit elektronik të datës 03.09.2019, kandidati ka dërguar kopje të skanuara të vertetimit datë 23.08.2019 lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, nga ku rezulton se z. {...} është i regjistruar në ciklin e tretë të studimeve Doktoraturë, në Departamentin e së Drejtës Civile më datë 17.12.2013 dhe ka ndjekur vitin teorik përgjatë vitit akademik 2014-2015. Por nuk rezulton që kandidati të ketë përfunduar studimet e doktoraturës dhe të ketë marrë gradën shkencore në drejtësi.

14. Në pretendimet e paraqitura në rrugë elektronike, z. {...} thekson se sipas këndvështrimit të tij, rezulton se në qofte se çdo kandidat duhet të ketë gradë shkencore në drejtësi atëherë referuar edhe teknikës legislative nuk do të ishte e nevojshme që kjo dispozitë kushtetuese (neni 136 pika 3) të behej me 7 rreshta, por thjesht do të percaktonte: **“Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit dhe çdo jurist që ka 15 vjet pune dhe gradë shkencore në drejtësi”**. Gjithashtu ai pretendon se arsyeja që ligjvënasi i ka përcaktuar më vete avokatët, dhe më vete profesoret ose lektorët e së drejtës dhe më vete juristet e institucioneve, është fakti që sipas tij, mbajtja e gradës shkencore është e detyrueshme vetëm për juristet e institucioneve pasi ata në ushtrimin e funksionit si jurist janë të kufizuar. Gjithashtu, ai ka referuar edhe burime si wikipedia mbi trajtimin e përkufizimit që i japin termit “jurist”.

14. Pas marrjes së shpjegimeve nga kandidati, duke e vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit të ndjekur deri në këtë moment dhe, në veçanti, verifikimet në lidhje me kushtin e kandidimit **“të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”**, mbi konsideratën se në rastin konkret verifikohet një rrethanë që ishte e aftë për të passjellë skualifikimin e kandidatit nga procedura e emërimit, **relatorja e çështjes ia parashtrori rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.**

15. Në Mbledhjen e **datës 09.09.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës**, duke i konsideruar të plota procedurat dhe verifikimet për këtë kusht kandidimi për z. {...}, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, **vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për skualifikimin e kandidatit për mosplotësimin e këtij kushti kandidimi ose për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.**

II. GJETJA E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT DHE VLERËSIMI I SAJ

1. Nga komunikimi me kandidatin, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur prej tij dhe nga e gjithë procedura e verifikimit e kryer lidhur me kandidimin e z. {...} verifikohet fakti se kandidati, z. {...}, **nuk mban gradë shkencore në drejtësi**.

2. Sipas nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. **Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi**”.

3. Sipas nenit 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, “Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”.

4. Nisur nga fakti që vërtetohet, si dhe në referim të ligjit të zbatueshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati, z. {...} , nuk zotëron gradë shkencore dhe nuk plotëson kushtin e kandidimit të përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

5. Po ashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor i vlerëson të rregullta dhe të plota procedurat e verifikimit të ndjekura deri në këtë moment për z. {...}, në veçanti verifikimet sa i përket këtij kushti kandidimi.

III. PRETENDIMET E KANDIDATIT DHE VLERËSIMI I TYRE

1. Në shpjegimet e tij në rrugë elektronike, kandidati, z. {...} thekson se sipas këndvështrimit të tij, rezulton se në qofte se çdo kandidat duhet të ketë gradë shkencore në drejtësi atëherë referuar edhe teknikës legjislativë nuk do të ishte e nevojshme që kjo dispozitë kushtetuese (neni 136 pika 3) të behej me 7 rreshta, por thjesht do të përcaktonte: “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit dhe çdo jurist që ka 15 vjet pune dhe gradë shkencore në drejtësi “. Gjithashtu ai pretendon se arsyeja që ligjvënasi i ka përcaktuar më vete avokatët, dhe më vete profesorët ose lektorët e së drejtës dhe më vete juristët e institucioneve, është fakti që sipas tij, mbajtja e gradës shkencore

është e detyrueshme vetem për juristet e institucioneve pasi ata në ushtrimin e funksionit si juristë janë të kufizuar. Gjithashtu, z. {...} referon faktin se ai vijon studimet e doktoraturës.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor i çmon të pabazuara pretendimet e kandidatit, z. {...}, se mbajtja e gradës shkencore është e detyrueshme vetem për juristet e institucioneve pasi ata në ushtrimin e funksionit si juristë janë të kufizuar.

2.1 Në lidhje me pretendime të tilla, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vlerëson se ligjvënësi ka qenë i qartë në përcaktimin e bërë në lidhje me kushtet dhe kriteret e vendosura për t'u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Në nenin 136, pika 3 të Kushtetutës thuhet se: *“Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi.”*

Ne nenin 49/1 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se: *“ Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.”*

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se kushtet kushtetuese dhe ligjore të kandidimit për në Gjykatën e Lartë nga radhët e jogjyqtarëve janë: 1) *Cilësimi “jurist i spikatur” me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës;* 2) *të pasurit e gradës shkencore në drejtësi.* Kushti i mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi është i detyrueshëm për të gjithë **“juristët e spikatur”** që kanë ushtruar këtë profesion në cilësinë e avokatit, profesorit apo lektorit të së drejtës, juristit të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të së drejtës.

3. Gjithashtu, Këshilli vlerëson se në kuptim të nenit 136/3 të Kushtetutës dhe nenit 49/1 të ligjit 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, kandidati duhet të ketë gradë shkencorë në drejtësi në momentin e paraqitjes së interesit për kandidim për një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë dhe nuk mund të konsiderohet mbajtja e gradës shkencore nëse kandidati është në proces studimesh apo mbrojtjeje të gradës.

3.1.Në nenin 70 dhe 77 të ligjit nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, përcaktohen kushtet dhe kriteret ligjore të lëshimit të gradës shkencore “Doktor”, duke parashikuar ndër të tjera se:

*“Programet e studimeve në institucionet e arsimit të lartë organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe **cikli i tretë**, referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë dhe diploma profesionale, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.”*

*“Cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimeve “Master ekzekutiv”, programet e studimeve specializuese afatgjata, si dhe **studimet e doktoratës**, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.*

*“Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. **Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”.**”*

4. Bazuar sa më sipër, Këshilli vlerëson se pretendimet e kandidatit, nuk mund të konsiderohen si të drejta me qëllim vërtetimin e kushtit ligjor të mbajtjes së gradës shkencore në drejtësi.

IV. KONKLUZIONE

1. Sa më lart, **Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidati, z. {...}, nuk plotëson kushtin e kandidimit për në Gjykatën e Lartë, atë të “mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”,** përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, **prandaj Këshilli është përpara rastit për të vendosur skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë ku ai ka konkurruar.**

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson po ashtu se në rastin konkret **nuk është e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit për këtë kandidat,** përse kohë, sipas ligjit, mosplotësimi edhe i një kushti të vetëm kandidimi passjell skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë.

PËR KETO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pika 1 dhe 5, të nenit 49 në lidhje me pikat 4, shkronja “c” dhe 6, të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “a”, të nenit 86 dhe nenet 97, 98 dhe 100, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “e”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për

procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI

1. Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019 dhe Vendimin nr. 110, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR